

Njoftim për përqendrim me të cilin ALFI Renewables, menaxhim me fonde alternative të investimeve, sh.p.k., dhe Kraftfeld Energie GmbH do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi PVP Cygnus S.R.L.

(lënda nr. 08-143/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 15.05.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga ana e ALFI Renewables, menaxhim me fonde alternative të investimeve, sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për menaxhimin e fondeve alternative të investimeve, e themeluar dhe që vepron në pajtim me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me seli të regjistruar në adresën Verovshkova ulica 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, dhe **Kraftfeld Energie GmbH**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që vepron në pajtim me ligjet e Republikës së Austrisë, me seli të regjistruar në adresën Parkring 4, 1010 Vjenë, Republika e Austrisë, të cilët do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi **PVP Cygnus S.R.L.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që vepron në pajtim me ligjet e Rumanisë, me seli të regjistruar në Bukuresht, Qarku 3, Rumani, në adresën Drumul Gura Putnei 45H, kati 1, banesa 5, dhoma 1.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste janë:

ALFI Renewables është shoqëri sllovene për menaxhim me fonde alternative të investimeve, e themeluar në fund të vitit 2020, me veprimtari prioritare të regjistruar – menaxhim me fonde (kodi i veprimtarisë: 6630).

ALFI Renewables menaxhon një fond të specializuar investimi - Fondi ALFI për burime të gjelbra të energjisë, Fond i Specializuar Investimi, me seli të regjistruar në adresën Verovshkova ulica 55A, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, me numër regjistrimi 8775958001, i cili kryen veprimtarinë e investimit të mjeteve të mbledhura nga investitorë të ndryshëm në pajtim me politikën e tij të investimeve, në elektrana me erë dhe fotovoltaike që prodhojnë energji elektrike përmes shfrytëzimit të energjisë së erës dhe diellit si burime natyrore të ripërtëritshme, mundësisht në fazën e ndërtimit ose në një fazë të mëvonshme të zhvillimit. Fokusi primar i investimeve të Fondit ALFI për Energji të Gjelbër janë Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

ALFI Renewables dhe Fondi ALFI për Energji të Gjelbër janë pjesë e një grupi më të gjerë nën kontrollin e pavarur të Grupit ALFI, prandaj konsiderohen si një pjesëmarrës i vetëm në treg në kuptim të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Grupi ALFI është aktiv kryesisht në menaxhimin e investimeve dhe pasurive, veçanërisht në fushat e shitjes me pakicë, arkëtimit të borxheve dhe investimeve të tjera alternative. Grupi ALFI kryen analiza të investimeve (potenciale) dhe menaxhon fondet e investimeve, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve u besohet pjesërisht shoqërive të tjera brenda grupit.

Në përbërjen e tij më të gjerë, Grupi ALFI ka shoqërinë të varur në vijim të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

- APOLLO MK SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në adresën Bulevardi Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Babë, Shkup, e cila është aktive me shitjen me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesoreve për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

Kraftfeld Energie është shoqëri austriake për burime të ripërtëritshme të energjisë, e specializuar në zhvillimin dhe menaxhimin e elektranave fotovoltaike (solare) në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. E themeluar në vitin 2009 si Pressburg Partners, shoqëria ka realizuar projekte me një vëllim investimesh që tejkalon 300 milionë euro dhe aktualisht ka kapacitete prej qindra megavatesh për burime të ripërtëritshme, të cilat momentalisht janë në fazën e zhvillimit në tregjet kyçe si Rumania, Hungaria dhe Austria. Që nga viti 2019, Kraftfeld Energie ka zhvilluar një portofol të fermave solare në Hungari, Rumani dhe Austri, duke kontribuar në zhvillimin e vet të vazhdueshëm në këto tregje kyçe. Shoqëria ka zyra në Vjenë, Budapest dhe Bukuresht dhe ka zhvilluar e menaxhuar ferma solare në gjashtë vende evropiane.

Grupi Kraftfeld zhvillon projekte solare dhe projekte për magazinimin e energjisë, duke përfshirë identifikimin e lokacioneve, sigurimin e lejeve rregullatore, inxhinieringun, prokurimin e pajisjeve, realizimin e punëve ndërtimore, me qëllim menaxhimin afatgjatë të projekteve për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar përmes marrëveshjeve për blerjen e energjisë elektrike ose në tregun e ditës aktuale.

Grupi Kraftfeld nuk është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PVP Cygnus është shoqëri rumune e themeluar në vitin 2021 si shoqëri me qëllim të veçantë për zhvillimin e Projekteve, me veprimtari prioritare - prodhim i energjisë elektrike.

PVP Cygnus aktualisht është në fazën përfundimtare të zhvillimit të dy projekteve në Rumani, ku secili projekt përfshin një sistem për magazinimin e energjisë elektrike.

PVP Cygnus është themeluar ekskluzivisht me qëllim të zhvillimit, ndërtimit dhe menaxhimit të Projekteve.

Rrjedhimisht, shoqëria ende nuk është aktive në treg, nuk ka kapacitet të instaluar dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur. Pas përfundimit të Projekteve, shoqëria do të menaxhojë parkun fotovoltaike, gjegjësisht do të prodhojë dhe shesë energji elektrike në Rumani, të prodhuar nga energjia diellore.

PVP Cygnus nuk është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit preliminar, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail:

kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Shkup

10.10.2025